

**SHTOJCAT**



# PËRMBAJTJA

SHTOJCA 1	Kuadri ligjor dhe nënligjor	4
SHTOJCA 2.	Dy modele të kontratës së praktikës profesionale	8
Modeli 1		8
Modeli 2		12
SHTOJCA 3.	Rregullore për zhvillimin e praktikës profesionale në shoqërinë tregtare nga nxënësit e shkollës profesionale	14
SHTOJCA 4.	Karta e identifikimit të nxënësit në praktikë profesionale	19
SHTOJCA 5.	Dy modele të vlerësimit të praktikës profesionale	20
Modeli 1		20
Modeli 2		22
SHTOJCA 6.	Dy modele të fletores së praktikës	23
Modeli 1		23
Modeli 2		24

## SHTOJCA 1. Kuadri ligjor dhe nënligjor

Praktika profesionale në vendin e punës është pjesë e rëndësishme e programit të miratuar mësimor të shkollave profesionale, i hartuar nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Baza ligjore për rregullimin e praktikës profesionale në vendin e punës përbëhet nga ligji “Për arsimin dhe formimin profesional (AFP)”, Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë, ligji “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, ligji “Për sigurimet shoqërore”, ligji “Për sistemin arsimor parauniversitar”, ligji “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre.

**Ligji nr. 8872, datë 29.3.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

- Neni 4/nj përcakton “formën e dyfishtë” në AFP si vijon “... kombinon arsimin dhe formimin në një institucion të AFP-së me punën dhe aftësimin praktik në një shoqëri tregtare, nëpërmjet përcaktimeve të një marrëveshjeje midis pjesëmarrësit, institucionit të AFP-së dhe shoqërisë tregtare”.
- Neni 18/1 përcakton “‘Shoqëria tregtare’ është subjekti ku mund të organizohen kurset e formimit nëpërmjet punës dhe ku mund të zhvillohen praktikat profesionale të nxënësve dhe të kursantëve të sistemit të AFP-së”.
- Neni 18/3 përcakton “Përfshirja e shoqërive në sistemin publik të AFP-së rregullohet me anë të marrëveshjeve që lidhen ndërmjet shoqërive tregtare dhe institucioneve ofruese arsimore publike. Kohëzgjatja e përfshirjes së shoqërive tregtare në sistemin publik kushtëzohet nga programet e praktikave profesionale dhe nga kurset e formimit.”

**Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar**

- Neni 98/4 përcakton “Fëmijët nga moshë 15 vjeç deri në moshën 16 vjeç mund të jenë subjekt i këshillimit dhe i formimit profesional, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”

- Neni 99/1 dhe 2 përcakton se fëmijët nga mosha 16 deri në moshën 18 vjeç mund të bëjnë punë të lehtë që nuk cenon sigurinë, shëndetin ose zhvillimin e tyre, dhe as pjesëmarrjen në shkollë.

**Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 384, datë 20.5.1996, i ndryshuar me VKM-në nr. 205, datë 9.5.2002, “Për mbrojtjen e të miturve në punë”**

- Pika 3, paragrafi i fundit, përcakton se të miturit mund të jenë subjekte të formimit profesional dhe se kur formimi ose stazhi në ndërmarrje janë organizuar nga autoritetet e ngarkuara me edukimin dhe formimin profesional nuk është i nevojshëm autorizimi i inspektoratit të punës.
- Pika 4, paragrafi i fundit, përcakton se kohëzgjatja e punës së lehtë nuk mund të kapërcejë 6 orë në ditë dhe as 30 orë në javë.

**Ligji nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”**

Dispozitat e këtij ligji, që synojnë garantimin e sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve, vlejnë edhe për nxënësit që kryejnë praktikë profesionale në vendin e punës. Në veçanti:

- Neni 34/1 përcakton se *“Të miturit mbrohen nga çdolloj rreziku, që vë në rrezik mirëqenien si dhe zhvillimin e tyre, si rrjedhojë e mungesës së përvojës, informacionit për një rrezik të mundshëm apo për shkak se ende nuk kanë arritur plotësisht pjekurinë e tyre.”*
- Neni 34/2 përcakton se *“Puna e të miturve ndalohet në rast se ajo:*
  - a) objektivisht kalon përtej kapacitetit fizik dhe psikik të tij;*
  - b) përfshin ekspozim të agjentëve toksikë, kancerogjenë, shkakton dëmtime të trashëgueshme gjenetike apo dëmtime, të cilat kanë efekte kronike në dëm të shëndetit përgjatë të gjithë jetës;*
  - c) përfshin ekspozim në rrezatime radioaktive;*
  - ç) përfshin rrezikun e aksidenteve, që mund të ndodhin, të cilat nuk mund të njihen apo të shmangen nga të miturit, për shkak të pakujdesisë së vëmendjes apo të pamjaftueshmërisë së përvojës apo të formimit;*
  - d) përbën rrezik për shëndetin si pasojë e të ftohtit apo të nxehtit ekstrem, zhurmave apo dridhjeve.”*

- Neni 35/1 përcakton se *“Punëdhënësi merr masa të nevojshme në mbrojtje të sigurisë dhe të shëndetit në punë për të miturit, duke marrë parasysh rreziqet specifike, sipas përcaktimeve në pikën 2 të nenit 34 të këtij ligji.”*
- Neni 35/2 përcakton se *“Punëdhënësi merr masa për vlerësimin e rreziqeve për të miturit në punën e tyre, i cili duhet të kryhet para fillimit të punës.”*

**Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar**

- Neni 6/ç parashikon sigurimin e detyrueshëm për kursantët dhe nxënësit për kohën e praktikës mësimore, të cilët sigurohen vetëm për aksidentin në punë nga punëdhënësit.

**Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”**

- Kreu I, pika 1/f, dhe kreu III, pika 12, përcaktojnë se nxënësit e shkollave të mesme apo profesionale si edhe studentët sigurohen nga punëdhënësi përkatës, për kohën e programuar të praktikës mësimore dhe praktikave profesionale pa pagesë, në masën 0.3% të pagës bruto minimale, e barabartë me 66 lekë në muaj, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për aq kohë sa është përcaktuar në kontratën përkatëse të lidhur ndërmjet palëve.

**Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 23, datë 9.12.2014, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**

- Pika 10.8 përcakton se subjekti tek i cili zbatohet programi i praktikës, në rubrikën e listëpagesës “Numri i kategorisë të punonjësve për kontributet” shënon: *Kategoria 28, që përfaqëson kategorinë nxënës i shkollës së mesme apo profesionale, apo student, për kohën e praktikës mësimore të miratuar nga institucionet përkatëse shtetërore.*

**Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 169, datë 8.05.2014, “Për disa ndryshime në dispozitat normative për sistemin arsimor parauniversitar”**

- Neni 31, *Vlerësimi i nxënësve në arsimin profesional*, pika 5, përcakton se për praktikën profesionale në industri/biznes, në bashkëpunim me biznesin, nxënësi vlerësohet në fund të realizimit të kësaj praktike.

**Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror”**

- Neni 21 përcakton se “Organet e Inspektoratit Sanitar Shtetëror kanë për detyrë të pajisin me librezë shëndetësore të gjithë personat që punojnë në objektet e prodhimit, të ruajtjes, transportimit dhe tregtimit të produkteve ushqimore, në ujësjellës, në institucione parashkollore, shkollore e shëndetësore dhe në objektet e shërbimit publik, ku mund të lehtësohet përhapja e sëmundjeve ngjitëse.”

# SHTOJCA 2. Dy modele të kontratës së praktikës profesionale

## MODELI 1

### Kontratë për realizimin praktikës profesionale të nxënësve në shoqëritë tregtare

#### Neni 1 Palët në kontratë

1. Palët kontraktuese			
Shoqëria tregtare	Emri:	Emri i përfaqësuesit:	
	Profili:		
	Adresa:	Tel.	
Nxënësi	Mbiemri:	Emri:	Data e lindjes:
	Adresa:	Tel.	
Prindi/ Kujdestari ligjor	Mbiemri:	Emri:	
	Adresa:	Tel.	
Shkolla	Emri:		
	Profili:	Emri i përfaqësuesit:	
	Adresa:	Tel.	
2. Kohëzgjatja e formimit profesional në punë			
Emërtimi i profesionit:			
Kohëzgjatja e formimit në punë			
Nga:	Deri më:		
Nga:	Deri më:		



## **Neni 2**

### **Objekti i kontratës**

1. Objekti i kontratës është realizimi i orëve të praktikës profesionale për vitin e dytë dhe të tretë të nxënësit të shkollës profesionale për periudhën e parashikuar në nenin 1 në shoqërinë tregtare.
2. Nxënësit gjatë kësaj praktike profesionale do të zhvillojnë njohuritë e tyre profesionale dhe do të vënë në provë aftësitë e tyre.

## **Neni 3**

### **Baza ligjore**

Kjo kontratë mbështetet në ligjin nr. 7361, datë 12.07.1995, “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 8872, datë 29.03.2015, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

## **Neni 4**

### **Afati dhe kohëzgjatja e praktikës profesionale**

Orët praktike fillojnë më \_\_\_\_\_ dhe përfundojnë më \_\_\_\_\_.  
Nxënësi do të ushtrojë praktikën e punës dy ditë në javë në shoqëri tregtare.  
Dita e punës do të jetë jo më shumë se 6 orë.

## **Neni 5**

### **Të drejtat dhe detyrimet e palëve**

1. ***Të drejtat dhe detyrimet e shkollës profesionale***
  - a) Të sigurojë dërgimin e nxënësve në shoqërinë tregtare sipas marrëveshjes së arritur më parë mes palëve.
  - b) Të sigurojë programin dhe orarin e kohës së praktikës.
  - c) Të mbështesë frymën e bashkëpunimit mes nxënësve dhe shoqërisë tregtare.
  - d) Të këshillojë instruktorët e shoqërisë tregtare për të zbatuar si duhet programin e praktikave.
  - e) Të ndjekë ecurinë e nxënësit/nxënëses gjatë praktikës në shoqërinë tregtare.
2. ***Të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë tregtare***
  - a) Të sigurojë specialistë të mirë për trajnimin e nxënësve.
  - b) Të sigurojë për nxënësit kushte të favorshme për të mësuar, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, sigurimin e kushteve higjienike, rregullat e sigurisë teknike, bazuar në *Kodin e punës së Republikës së Shqipërisë*.

- c) Të udhëzojë nxënësit dhe ta vendosë për të punuar në pozicione të ndryshme në bazë të programit të praktikës.
- d) Në fund të praktikës duhet të ketë një vlerësim të saj për secilin nxënës.

### 3. **Të drejtat dhe detyrimet e nxënësit**

- a) Që nga fillimi i praktikës profesionale, nxënësi ka të drejtë të informohet nga shkolla dhe instruktorët e shoqërisë tregtare për të drejtat dhe detyrimet e tij.
- b) Nxënësi është i detyruar të marrë pjesë rregullisht në programin e praktikës dhe të respektojë disiplinën në punë.
- c) Ai duhet të respektojë rregullat e sigurisë teknike të shoqërisë tregtare.
- d) Nxënësi duhet të kontaktojë me shkollën dhe shoqërinë tregtare kur mungon gjatë orëve të praktikës.
- e) Nxënësi nuk duhet të punojë në asnjë post pune apo makineri që ai nuk e ka mësuar më parë në teori dhe në çfarëdolloj makine që nuk është e garantuar siguria teknike.
- f) Nxënësi zbaton udhëzimet e mjeshtrit të praktikës, kryen me ndërgjegje punët që i caktohen dhe ruan sekretin profesional.
- g) Nxënësit i kërkohet të mësohet me një sjellje korrekte, rregull, saktësi dhe punë të denjë.

## **Neni 6**

### **Sigurimi nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale**

Për nxënësit e shkollave të mesme profesionale, për kohën e programuar të praktikave profesionale, do të paguhen kontribute nga shoqëria tregtare, në nivelin minimal, vetëm për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, për atë kohë sa është përcaktuar në këtë kontratë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 7**

### **Zgjidhja e kontratës**

Kjo kontratë mund të zgjidhet vetëm nga shkolla profesionale, prindi ose përfaqësuesi ligjor i nxënësit dhe shoqëria tregtare.

Ndërprerja e marrëdhënieve kontraktore për praktikën profesionale bëhet:

- a) Kur afati i caktuar në këtë kontratë ka mbaruar.

- b) Në qoftë se shoqëria tregtare dështon në përmbushjen e detyrimeve, kjo kontratë përfundon sipas procedurave ligjore.
- c) Kur nxënësi nuk i ka aftësitë fizike ose intelektuale të domosdoshme për formimin e tij/e saj profesional si dhe për rastin kur shëndeti apo morali i tij/e saj komprometohet nga ky formim.
- d) Kur nxënësi shkel detyrimet e kontratës së realizimit të praktikës profesionale.
- e) Kur nxënësit i provohet fajësia për ndonjë vepër penale në ngarkim të tij/të saj dhe dënohet me vendim të formës së prerë te një gjykatë.
- f) Kur nxënësi nuk zbaton rregulloren e brendshme të funksionimit të shoqërisë tregtare/kompanisë apo institucionit ku mëson dhe shkel në mënyrë të përsëritur disiplinën e mësimit apo praktikës, me gjithë paralajmërimet e instruktorit.
- g) Kur provohet se nxënësi shpërdoron pronën e shoqërisë tregtare.
- h) Kur provohet se nxënësi nxjerr të dhëna konfidenciale të shoqërisë tregtare.

## **Neni 8**

### **Dispozita të fundit**

Kontrata hyn në fuqi pas nënshkrimit nga palët.

Kjo kontratë hartohet në tri kopje origjinale, një kopje për secilën palë.

Vendi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Shoqëria tregtare

Shkolla profesionale

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Kujdestari ligjor

Nxënësi

<b>Kontrata e praktikës profesionale</b>		Logo e shkollës	Nr. i kontratës
Në tri kopje			

Pasi morën dijëni për rregulloren dhe dokumentet e tjera bashkëngjitur, palët e përmendura më poshtë bien në ujdë për kontratën që vijon:

1. Palët kontraktuese			
<b>Shoqëria tregtare</b>	Emërtimi	Emri i përfaqësuesit ligjor	NIPT
	Profili		Tel.
	Adresa		
<b>Nxënësi</b>	Mbiemri	Emri	Datëlindja
	Adresa		Tel.
<b>Prindi</b> (ose përfaqësuesi ligjor)	Mbiemri	Emri	
	Adresa		Tel.
	Emërtimi		
<b>Shkolla profesionale</b>	Profili	Emri i përfaqësuesit ligjor	
	Adresa		Tel.
2. Profesioni dhe periudha e praktikës profesionale			
	Emërtimi i profesionit		
	Periudha e praktikës	nga      në	nga      në

### 3. Elementet e kontratës

Përgjegjësi i praktikës në shoqërinë tregtare	Mbiemri	Emri
Mësuesi / instruktori përgjegjës për monitorimin	Mbiemri	Emri
	Tel.	
	Tel.	

Orari i praktikës profesionale	Hënë	Martë	Mërkurë	Enjte	Premte	Shtunë
Nga ora						
Në orën						

### Dokumentet shoqëruese të kontratës \*

a. Rregullorja e praktikës profesionale	b. Programi orientues i praktikës profesionale
c. Formulari i vlerësimit të praktikës profesionale	d. Formulari i fletores së praktikës profesionale

\* Kontrata është e vlefshme vetëm e shoqëruar me dokumentet e përmendura

### 4. Nënshkrimi i kontratës

### Data e miratimit dhe vula

Data

Përfaqësuesi i shoqërisë tregtare

Nxënësi

Prindi (ose përfaqësuesi ligjor)

Përfaqësuesi i shkollës profesionale

Vula e shkollës profesionale

## SHTOJCA 3. Rregullore për zhvillimin e praktikës profesionale në shoqërinë tregtare nga nxënësit e shkollës profesionale

### Qëllimi

Praktika profesionale në biznes synon të japë aftësitë dhe njohuritë e domosdoshme për ushtrimin e një profesioni si dhe të zhvillojë kulturën e punës, personalitetin dhe ndjenjën e përgjegjësisë. Ajo gjithashtu shërben si themel për kualifikimin e mëtejshëm.

### 1. Nxënësi

#### *Të drejtat*

Nxënësi ka të drejtë të informohet që në fillim nga shkolla dhe shoqëria tregtare mbi të drejtat dhe detyrat e tij.

#### *Detyrimet*

Nxënësi është i detyruar të frekuentojë rregullisht praktikën sipas programit dhe të respektojë disiplinën e punës së shoqërisë tregtare. Përgjegjësi i tij direkt është mjeshtri i praktikës.

Nxënësi është i detyruar të justifikojë mungesat e mundshme si të gjithë punonjësit e tjerë të biznesit. Mungesat merren parasysh në vlerësimin përfundimtar të praktikës.

Nxënësi zbaton udhëzimet e mjeshtrit të praktikës, kryen me ndërgjegje punët që i caktohen dhe ruan sekretin profesional.

Nxënësit i kërkohet të mësohet me një sjellje korrekte, rregull, saktësi dhe punë të pastër.

## 2. Programi orientues i praktikës profesionale

Për çdo profesion përgatitet një program orientues praktike, i cili është pjesë përbërëse e kontratës. Programi orientues i praktikës përmban një listë sa më të plotë punimesh, kompetencash dhe njohurish ndaj të cilave nxënësi ekspozohet gjatë praktikës. Aktiviteti i bizneseve që zgjidhen të marrin nxënës për praktikën profesionale mbulon sa më mirë programin orientues të praktikës, e cila është objekt i një përsosjeje periodike që kryhet me pjesëmarrjen e shkollës dhe bizneseve të interesuara.

Në fillim të praktikës nxënësit i caktohet vendi i punës dhe i vihen në dispozicion pajisjet dhe veglat e nevojshme.

Me qëllim që të nxitet aftësia profesionale e nxënësit, punimet duhet të përsëriten në mënyrë të alternuar. Nxënësi duhet mësuar në mënyrë që në fund të praktikës të jetë në gjendje të kryejë në mënyrë të pavarur dhe në një kohë të arsyeshme sa më shumë punime që përmenden në programin orientues të praktikës.

Nxënësi duhet të informohet menjëherë mbi rreziqet shëndetësore që rrjedhin nga kryerja e punimeve dhe t'i shpjegohet teknika e sigurimit.

## 3. Sigurimi nga aksidentet në punë

Shoqëria tregtare kujdeset të bëjë në afatin e kërkuar sigurimin e detyrueshëm të nxënësit nga aksidentet dhe sëmundjet profesionale, për kohën e praktikës profesionale të përcaktuar në kontratë, sipas kuadrit ligjor në fuqi.

## 4. Kontrata e praktikës

### *Objekti i kontratës*

Kontrata e praktikës lidhet individualisht për secilin nxënësi. Ajo përcakton natyrën dhe kohëzgjatjen e praktikës, orarin javor të punës dhe ditët e pushimit.

### *Miratimi i kontratës*

Kontrata e nënshkruar ndërmjet shoqërisë tregtare, shkollës, nxënësit dhe prindit (ose përfaqësuesit ligjor), sipas një modeli të pranuar, zyrtarizohet nga shkolla përpara fillimit të praktikës dhe i kthehet palëve.

Pjesë të kontratës janë edhe vetë kjo rregullore, programi orientues i praktikës, formulari i vlerësimit dhe formulari i fletores së praktikës.

### ***Përcaktimi i afatit të lidhjes së kontratës***

Kontrata duhet të lidhet që në fillim të vitit shkollor, por jo më vonë se dy javë përpara fillimit të praktikës profesionale.

### ***Zgjidhja e kontratës***

Kontrata e praktikës nuk mund të zgjidhet në asnjë rast pa dijeninë e shkollës. Në raste të rënda pala e interesuar njofton menjëherë shkollën, e cila, përpara se kontrata të zgjidhet, ndërhyr për një zgjidhje të mundshme nëpërmjet një takimi të përbashkët me palët.

## **5. Koha e punës dhe pushimit gjatë praktikës profesionale**

Koha e punës dhe pushimit të nxënësit gjatë praktikës profesionale rregullohet sipas dispozitave të kodit të punës dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

## **6. Fletorja e praktikës profesionale**

Nxënësi është i detyruar të mbajë fletoren e praktikës, në të cilin shënon sistematikisht çdo gjë që lidhet me njohuritë, punën, qëndrimin ndaj saj etj., ndaj të cilave ai ekspozohet gjatë praktikës. Për këtë arsye atij duhet t'i lejohej edhe koha e nevojshme gjatë orarit të punës.

Fletorja e praktikës i përket nxënësit, por mjeshtri i praktikës ka të drejtë ta kontrollojë atë periodikisht.

## **7. Mjedisi i praktikës profesionale**

### ***Numri i nxënësve***

Numri i nxënësve që kryejnë njëkohësisht praktikën profesionale në një shoqëri tregtare të caktuar është në përpjesëtim me specialistët e punësuar prej saj. Me miratimin e shkollës, numri i nxënësve mund të rritet, në qoftë se nuk preket cilësia e praktikës profesionale.



## 8. Mjeshtri i praktikës

### *Cilësitë e mjeshtrit të praktikës*

Gjatë praktikës profesionale nxënësit mund të praktikohen vetëm nën drejtimin e mjeshtrit të praktikës, që ka aftësinë profesionale, cilësitë personale të nevojshme dhe që ofron të gjitha garancitë për një praktikë profesionale të përshtatshme dhe pa rreziqe për shëndetin dhe moralin e tyre.

Mjeshtri i praktikës mund të jetë përgjegjësi i biznesit ose një bashkëpunëtor i caktuar prej tij që përmbush cilësitë e kërkuara.

### *Mohimi i së drejtës për të drejtuar praktikën*

Shkolla ka të drejtën që t'i mohojë të drejtën për të drejtuar praktikën atij mjeshtri të praktikës që nuk përmbush cilësitë e përshkruara më sipër ose që dhunon rëndë detyrimet ligjore.

### *Detyrimet e mjeshtrit të praktikës*

Mjeshtri i praktikës udhëheq me kompetencë dhe në mënyrë sistematike praktikën, duke iu përmbajtur sa më shumë programit orientues që i bashkëngjitet kontratës.

Mjeshtri i praktikës ka përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për të caktuar detyrat, për të instruktuar dhe për të konsultuar nxënësin, për të mbikëqyrur sistematikisht punën dhe respektimin rigoroz të orarit dhe të disiplinës së punës prej tij si për të gjithë punonjësit e tjerë të biznesit.

Në qoftë se praktika nuk ecën mirë, ai informon menjëherë përfaqësuesin e shkollës.

Mjeshtri i praktikës i kërkon nxënësit të kryejë vetëm punë që kanë lidhje me programin orientues të praktikës profesionale.

## 9. Vlerësimi i praktikës

Në fund të periudhës së praktikës profesionale, specialisti që e drejton dhe mbikëqyr nxënësin, i mbështetur nga ana metodike prej mësuesit/instrukturit të shkollës përgjegjës për monitorimin, vlerëson praktikën sipas një modeli të

përgatitur nga shkolla, ku përfshihen kritere mbi sjelljen personale, qëndrimin ndaj punës, cilësinë dhe rendimentin në punë. Vlerësim i komunikohet nxënësit.

## 10. Prindi (ose përfaqësuesi ligjor)

Prindi (ose përfaqësuesi ligjor) i nxënësit mbështet mjeshterin e praktikës dhe shkollën të përmbushin detyrat e tyre dhe nxit bashkëveprimin e mjeshtrit, nxënësit dhe shkollës.

## 11. Mbikëqyrja e praktikës nga shkolla


### *Kontrolli nga përfaqësuesi i shkollës*

Përfaqësuesi i shkollës ka të drejtë të mbikëqyrë kryerjen e praktikës profesionale me anë të vizitave të planifikuara nga shkolla ose me kërkesë të palëve të tjera kontraktuese.

Gjatë vizitave përfaqësuesi i shkollës ka të drejtë dhe detyrë:

1. të mbështesë mjeshterin e praktikës në realizimin e detyrës së tij;
2. të marrë intervista me nxënësit;
3. të verifikojë shkallën e përfitimit prej praktikës nga pikëpamja e programit orientues të praktikës;
4. të kontrollojë fletoren e praktikës së nxënësit;
5. të verifikojë nëse përmbushen kushtet për kryerjen e praktikës;
6. të këshillojë mjeshterin e praktikës lidhur me përmbushjen sa më mirë të programit orientues të praktikës;
7. të punojë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme ndërmjet palëve.

## SHTOJCA 4. Karta e identifikimit të nxënësit në praktikën profesionale

<b>Karta e identifikimit të nxënësit në praktikën profesionale</b>	
 <p>Foto e nxënësit</p>	<p><b>Emri Mbiemri</b> <b>Datëlindja</b> <b>Shkolla</b> <b>Emërtimi i shoqërisë tregtare</b> <b>Periudha e vlefshmërisë</b></p>
<b>Nënshkrimi i përfaqësuesve</b>	
<b>për Shoqërinë tregtare</b>	<b>për Shkollën profesionale</b>
<b>NIPT</b>	<b>Vula</b>

# SHTOJCA 5. Dy modele vlerësimi të praktikës profesionale

## MODELI 1

### VLERËSIMI I NXËNËSIT PRAKTIKANT

Data: \_\_\_ / \_\_\_ / 201\_

Ky është një PYETËSOR PËR BIZNESET në lidhje me sjelljen e nxënësve gjatë praktikës. Ne kërkojmë nga ju si përfaqësues i biznesit opinionin tuaj rreth sjelljes së nxënësit gjatë praktikës në biznesin/kompaninë apo zyrën tuaj.

(Emri i nxënësit praktikant): \_\_\_\_\_

Vendosni një shenjë në germën që përshtatet me vlerësimin tuaj.

A = shkëlqyeshëm (9-10); B = mirë (8-7); C = mjaftueshëm (6-5); D = jo mjaftueshëm

KOMPETENCAT		Nota:
<b>NJOHURITË PROFESIONALE: A i kupton nxënësi teknikat bazë?</b>		A - B - C - D
<b>AFTËSI</b>	<b>Aftësi praktike: Aftësi për të zbatuar në mënyrë të pavarur teknikat bazë</b>	A - B - C - D
	Aftësi për të bërë analizë teknike	A - B - C - D
	Aftësi për të menduar në mënyrë kritike	A - B - C - D
	Aftësi për zgjidhjen e problemeve	A - B - C - D
	Aftësi në gjuhë – aftësi komunikuese	A - B - C - D
<b>SJELLJE</b>	Rregulli gjatë punës	A - B - C - D
	Përpikëria në punë	A - B - C - D
	Shpejtësia në punë	A - B - C - D
	Motivimi dhe dedikimi në punë	A - B - C - D
	Vëmendja dhe interesi për punën	A - B - C - D
	Puna e pavarur - aftësia për të ndërmarrë iniciativa, të punuarit në mënyrë të pavarur	A - B - C - D
	Sjellja sociale dhe puna në grup (qëndrimi kundrejt bashkëpunëtorëve)	A - B - C - D
	Të qenit fleksibël, krijues dhe në kërkim të gjetjeve të reja	A - B - C - D
	Besueshmëria dhe kujdesi për të mirat materiale	A - B - C - D
	Përfundimi: Kryerja e një detyrë në mënyrë të plotë dhe të duhur	A - B - C - D
	Të kuptuarit e cilësisë së mirë të punës	A - B - C - D
	Respekti, qëndrimi pozitiv (toleranca, mirësjellja, gjuha e përshtatshme, pa sharje, pranimi i autoritetit, respekti për të gjitha kulturat)	A - B - C - D
<b>Vlerësim i përgjithshëm:</b>	A - B - C - D	

**Shënime.** Këtu mund të vlerësoni aspektet pozitive të sjelljes së praktikantit, por jepni gjithashtu edhe mendimet rreth sjelljeve që mund të jenë problematike në vendin e punës dhe që si rrjedhojë kërkojnë ndryshime.

---

---

---

**Vlerësim i përgjithshëm i arsimit dhe formimit profesional në shkollën profesionale:**

Si është përgatitja teorike e nxënësve praktikantë?	A – B – C – D
Si është përgatitja praktike e nxënësve praktikantë?	A – B – C – D

Emri i kompanisë \_\_\_\_\_

Emri i vlerësuesit: \_\_\_\_\_

Firma: \_\_\_\_\_

## Vlerësimi i praktikantit gjatë praktikës

Emri i mjeshtrit  
të praktikës: \_\_\_\_\_

Emri  
i praktikantit: \_\_\_\_\_

Periudha  
e vlerësuar: \_\_\_\_\_

Data  
e bashkëbisedimit: \_\_\_\_\_

Kriteret	Sjelljet e veçanta	Shumë mirë	Mirë	Mjaftue-shëm	Dobët
Sjellja personale	Komunikimi me eprorin				
	Komunikimi me kolegët				
	Komunikimi me klientët				
	Pastërtia dhe rregulli i vendit të punës				
	Pastërtia e veglave të punës				
	Përpikëria në orar				
Qëndrimi ndaj punës	Pranimi i punëve të reja				
	Dëshira për të mësuar				
	Durimi (puna pa ndërprerje)				
	Të mësuarit nga gabimet				
	Kujdesi ndaj makinerive dhe veglave				
	Përdorimi i materialeve				
Cilësia e punës	Pavarësia në detyrat e zakonshme				
	Pavarësia në detyrat e vështira				
	Precesioni				
	Shpeshtësia e gabimeve				
	Vetëkontrolli i gabimeve				
	Cilësia krahasuar me punën e ekspertit				
Sasia e punës	Shpejtësia në detyrat e zakonshme				
	Shpejtësia në detyrat e vështira				

### Qëndrime (sjellje) për t'u përmirësuar:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_



## Raport i praktikës profesionale

Mësuesi përgjegjës: \_\_\_\_\_ Nr. tel. : \_\_\_\_\_

Kompania (Emri, adresa dhe nr. tel.): \_\_\_\_\_

---

### Rregulla të përgjithshme për zbatimin e praktikës në kompani:

1. Në rast sëmundjeje, unë duhet të informoj kompaninë/ndërmarrjen dhe mësuesin përgjegjës menjëherë. Nëse kompania/ndërmarrja nuk është e arritshme, atëherë shkolla duhet të informohet (minimumi 15 min përpara fillimit të orarit të punës). Më pas, duhet të dorëzohet një letër me shkrim ku të kërkohet të falur.
2. Duhet t'i përgjigjem rregullimeve të bashkëpunëtorëve të kompanisë/ biznesit. Unë duhet t'ia drejtoj ankesat mësuesit përgjegjës.
3. Fillimi i punës në kohë dhe pastërtia në punë janë kushtet natyrale të punës. Në mënyrë që të jem i/e përpiktë, duhet të gjej rrugën më të sigurt për në kompani/biznes.
4. Unë jam I FTUAR në kompani/biznes. Rregullat e mikpritjes duhet të merren në konsideratë. Prandaj duhet të sillem me mirësjellje me klientët dhe kolegët.
5. Për çdo paqartësi, unë duhet të pyes bashkëpunëtorët ose mësuesin përgjegjës.
6. Për pirjen e duhanit janë të vlefshme/zbatohen rregullat e shkollës dhe rregullat e veçanta të kompanisë/biznesit.
7. Për kursin e praktikës profesionale janë të vlefshme/zbatohen ligjet për mbrojtjen e punëtorëve minorenë (p.sh., orari i punës, pushimet, llojet e aktivitetëve, moslejimi i ndëshkimit trupor).



8. Duhet të përdor me kujdes makineritë dhe pajisjet, sepse makineritë mund të jenë të rrezikshme. Unë duhet të zbatoj rregullat e sigurisë (p.sh., mbrojtësin e syve, këpucët e sigurisë).
9. Unë jam informuar nga bashkëpunëtorët e kompanisë/biznesit për mbajtjen e sekreteve të tregtisë dhe sekreteve profesionale. Këto rregulla janë të vlefshme edhe për mua!
10. Broshura e kursit të praktikës profesionale duhet të mbahet pastër dhe ashtu siç duhet.
11. Unë duhet të kërkoj në fund të kursit të praktikës profesionale vlerësimin nga supervizori përgjegjës në kompani dhe pas mbarimit të kursit të praktikës ta dorëzoj atë në shkollë.





## II. VETËVLERËSIMI I PRAKTIKANTIT

Kompania/ndërmarrja vlerëson kompetencën tuaj teknike gjatë kursit të praktikës. Ju duhet të bëni një vlerësim të aftësive tuaja këtu. Kjo i referohet në veçanti kohës gjatë praktikës!

Njohuri dhe aftësi të cilat i keni fituar gjatë praktikës së specializuar dhe gjatë mësimit, të cilat ju keni mundur t'i përdorni gjatë punës në kursin e praktikës!

*(Përbajtja e funksioneve dhe njohurive duhet të përshatet nga mësuesit e specializuar të praktikës!)*

<b>Funksione dhe njohuri profesionale</b>	Unë mund t'i përdorja shpesh gjatë praktikës	Unë mund t'i përdorja rrallë	Unë nuk i kam përdorur
Përthyerje telash dhe saldime me kallaj			
Të mas gjatësinë			
Matematikë e thjeshtë +, -, *, /			
Përlogaritja e përqindjeve dhe e interesit			
Leximi dhe vizatimi i skicave			

Punë më tela dhe kablllo				
Të punoj me materiale metalike, druri apo të tjera (sharrë, limë, trapan ...)				
Të bëj punë me shkrim				
Të punoj në kompjuter				
Të kem biseda me konsumatorët (personalisht ose përmes telefonit)				
Të punoj në magazinë				

Aftësitë e mia	Eshhtë e vërtetë gjithmonë	Eshhtë shpesh e vërtetë	Eshhtë pak/ndonjëherë e vërtetë	Eshhtë rrallë e vërtetë	Nuk është e vërtetë kurrë	Nuk mund të bëhet asnjë deklaratë
Unë i përmbahem takimeve të caktuara ( <i>Përpikëria</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Përpiqem të bëj një punë tjetër nëse kam mbaruar një detyrë ( <i>të qenit proaktive</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të punoj për një kohë të gjatë dhe në mënyrë të përqendruar për të kryer detyrat ( <i>përqendrimi</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë i pranoj kritikën e eprorëve dhe kolegëve pa i zbrapsur menjëherë dhe jam i/e hapur për ndihmë dhe mbështetje ( <i>aftësia për të pranuar kritikën</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të punoj saktë, besnikërisht dhe me kujdes ( <i>kujdesi</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë punoj mirë në bashkëpunim me kolegët dhe eprorët e mi ( <i>aftësia në grup/skuadër</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Unë mund të kuptoj shpjegimet dhe mund t'i zbatoj ato ( <i>interpretimi</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të identifikoj gabimet e mia dhe t'i përmirësoj ato në mënyrë autonome ( <i>kontrolli kritik</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mësoj shpejt dhe mund t'i mbaj mend mirë gjërat ( <i>të mësuarit/kujtesa</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të zbatoj urdhrat e punës në mënyrë autonome ( <i>pavarësia</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë e mbaj vendin tim të punës të pastër dhe të rregullt ( <i>rregulli</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të përshattem shpejt me rregullat dhe kërkesat e një pune të re ( <i>aftësia për të ndërruar postet / për t'u përshtatur/fleksibiliteti</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të hyj lehtësisht në bisedë me kolegët e mi, eprorët dhe klientët dhe mund t'i pyes kur diçka është e paqartë ( <i>aftësia për të kontaktuar</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë mund të punoj për një kohë të gjatë në një detyrë dhe të mos heq dorë lehtësisht ( <i>rezistenca</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë punoj mjaft ( <i>shpejtësia</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë jam në gjendje të përballoj ngarkesat fizike ( <i>shëndeti fizik</i> )	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

## Vlerësime shtesë

	Është e vërtetë gjithmonë	Është shpesh e vërtetë	Është pak/ndonjëherë e vërtetë	Është rralle e vërtetë	Nuk është e vërtetë kurrë	Nuk mund të bëhet asnjë deklaratë
Unë jam/isha i kënaqur me veten time (kënaqësia)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë jam i/e gatshëm të punoj për këtë fushë (aftësia për punësim)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Unë jam i aftë për arsim profesional (aftësia për arsim profesional)	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shënime shtesë: \_\_\_\_\_

---



---



---



---



---



---